



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 269/17

Nr. i fq. / Br. st - 20 -

Data: / Datum 28.09.2017

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL  
NGA MBLEDHJA E -VII- (E SHTATË ) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS  
SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 KORRIK 2017

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërzhaliu, Isa Hajrizi, Ilmi Azemi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

**Mungoi: Selim Rrustemi**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, Nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – propozoi që në pikën në të ndryshme të futet, propozimi për heqjen e kushtëzimit të pagesës së taksës për mbeturinat ndaj qytetarëve me ofrimin e shërbimeve komunale.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – kërkoi sqarime lidhur me qendrën e grumbullimit të mbeturinave për objektin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e atij objekti.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – propozoi që të futet në rend dite, propozimi por caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Gllavatin.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se kuvendi tashmë e ka aprovuar planin dhe rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, dhe me këto dokumente parashihet që inkasimi i taksave për mbeturinat të bëhet nga komuna, dhe se komunës i lejohet të përdorë instrumente të ndryshme për inaksimin e taksave. Gjithashtu këtë të drejtë komunës ia jep edhe Ligji për Mbeturinat dhe komuna natyrshëm që do t'i përdorë të gjithë mekanizmat ligjor për rritjen e të hyrave nga kjo kategori, me qëllim të avancimit të cilësisë së shërbimeve për qytetarët në aspektin e menaxhimit të mbeturinave. Në fund ai njoftoi se Drejtoria e Shërbimeve Publike është në vllugun e punëve për nënshkrimin e një memorandum-bashkëpunimi me Gizin gjerman për rritjen e cilësisë së shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave.

**Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me çështjen e kushtëzimit të pagesës të kësaj takse, duke shtuar se kjo rregull parashihet në planin dhe rregulloren e menaxhimit të mbeturinave dhe këto dokumente janë aprovuar nga kuvendi i komunës dhe kanë marrë confirmimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja.

*Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 25 vota "për" të tjerat "abstenim" aprovoi këtë:*

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 29.06.2017;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 04.05.2017;
3. Shqyrtimi i parë i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar-qershor 2017;
5. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt; prill, maj, qershor 2017;
6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/2017;
7. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2017;
8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore në Komunën e Vushtrrisë;
9. Shqyrtimi i njoftimit për Raportin e auditotit të përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2016;
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shndërrimin e projektit njëvjeçar në projekt dyvjeçar për hartimin e hartës zonale në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për destinimin e "shtëpisë së Mahmut agë Gjinolli" në muze historik-etnografik;
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vlerës financiare për ndërtimin e objektit shkollor në fshatin Dumnicë e Llugës;
13. Shqyrtimi i Draft-planit për përmirësim të shërbimit –Mobiliteti në trafik 2017-2019 **(shqyrtimi i dytë)**;
14. Shqyrtimi i Draft-planit Zhvillimor Komunal të Arsimit 2017-2019 **(shqyrtimi i dytë)**;
15. Shqyrtim i petitionit të banorëve të fshatit Pestovë;
16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për krijim të marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe partneritetit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Norwalk të IOWA-s (SHBA);
17. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozimit për heqjen e taksës për mbeturinat, si kusht për ofrimin e shërbimeve komunale;
  - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit të UÇK- së;
  - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të lira të komunës;
  - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare të komunës;
  - d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Hasime Ahmetin;
  - dh). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Fahrije Gërgurin
  - e). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Naser Hysenin;
  - ë). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 29.06.2017

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 29.06.2017.*

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 04.05.2017

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit e datës 04.05.2017;*

3. Shqyrtimi i parë i Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – propozoi që zona e parë tatimore të ndahet në dy nënzona, si dhe duhet të punohet që prona të ndahet në etazhe pasi që vlera e banesave nuk është e njëjtë p.sh sikur në katin e parë apo në katin e dhjetë, andaj këtu ndryshon vlera dhe analog me këtë duhet të ndryshojë edhe vlera e tatimit.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018.

2. Diskutimi publik fillon nga data 01 gusht 2017 dhe zgjat deri më 31 gusht 2017.

3. Obligohet Zyra komunale për informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa (DBF) dhe komisioni për hartimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018, që si hartues dhe propozues i aktit në fjalë të organizojë diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna Nr. 01/2015, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t’ia prezantojë Kuvendit të Komunës në rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin shtator 2017.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar-qershor 2017

5. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet buxhetore për muajt; prill, maj, qershor 2017

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se kjo informatë me të gjitha elementet që përmban si për të hyrat dhe shpenzimet, na bënë me dije se duhet të kemi një mobilizim për periudhat e ardhshme. Pastaj shtoi se në të kaluarën nuk kemi asnjë vendim për aprovimin e

raporteve qoftë ato periodike apo vjetore, dhe tani shtrohet pyetja se kemi obligim ligjor si kuvend që t'i aprovojmë këto raporte apo jo. Nga të dhënat e informatës shihet se kemi ngecje sa i përket realizimit të investimeve kapitale me vetëm me 21 %. Mandej mbetja e borxheve të painksuara në shumën prej 2, 197.000 € nga tatimi në pronë, taksa në firmë për afro 500.000 €, pastaj shfrytëzimi i pronës me 27,700 € janë shuma të mëdha për komunën tonë në ç'rast shihet se kemi nevojë për një plan operativ për inkasimin e këtyre obligimeve. Dukuri tjetër që është vërejtur edhe më herët është çështja e parashikimit joreal të gjobave të gjykatave që krahasuar me plane që janë bërë më herët kemi 2 % realizim. Në këtë kontekst apeloj për angazhim gjithëpërfshirës për rritje të të hyrave vetanake si burim kryesor i komunës e që deri në këtë periudhë kanë qenë 37 %.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – duke iu referuar informatës në fjalë, ceku se planifikimi i të hyrave nga fusha e inspektimeve nga 25.500 € sa janë planifikuar janë realizuar në 42 %, këtu duhet të dihet kriteri i planifikimit të këtyre të hyrave. Parkingjet janë shfrytëzuar vetëm 29% nga ajo sa ka qenë e planifikuar. Pastaj shfrytëzimi i pronës publike 18 %, është jashtëzakonisht bilanc i varfër i shfrytëzimit të pronës publike, dhe për këtë duhet të dihen arsyet. Mandej gjobat e trafikut dhe ato të gjykatave gjithashtu duhet të dihen kriteret e planifikimit të këtyre të hyrave nga këto kategori. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve pozicioni i mëditjeve jashtë vendit shuma prej 3,431 €, kjo shumë është më e vogël krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, për këtë kërkoi të informohet për qëllimin e shfrytëzimit të këtyre mjeteve për mëditje, dhe nga kush janë shfrytëzuar. Shpenzimet për internet janë zero, dhe kjo ta krijon përshtypjen se interneti nuk ka funksionuar fare në komunë gjatë vitit 2016, kurse gjatë vitit 2017 i kemi 1077.0.50 €, shpenzimet e telefonisë mobile, krahasuar me vitin e kaluar janë rritur për afro 48%. Shërbimet e arsimit dhe trajnimit 5.154 € për vitin e kaluar, kurse këtë vit 1.445 €, për këtë pyeti se me këto mjete çfarë shërbimesh dhe trajnimesh janë kryer. Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse kërkoi për këtë të jepen sqarime. Shpenzimet për anëtarësim ceku se nuk i kupton dhe kërkoi sqarime. Karburantet për vetura kemi përmirësime nga viti i kaluar sepse këto shpenzime janë më të zvogëluara për këtë vit. Pastaj përsëriti se nuk e ka kuptuar dhe nuk e kupton akoma se çka është mirëmbajtja rutinore çka do të thotë ky lloj shpenzim, kërkoi të sqarohet. Shpenzimet për drekat zyrtare janë dyfishuar nga viti i kaluar për këtë kërkoi që këto shpenzime të precizohen dhe të arsyetohen.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – ceku se kodi ekonomik 13320, kategoria shpenzimet e telefonisë mobile në vitin 2016 kanë qenë 6120 € kurse tani janë rreth 12.000 € që i bie se kemi dyfishim të shpenzimeve për periudhën e njëjtë. Mandej tek kodi 14210 reklamat dhe konkurset vlera është 195 € për vitin e kaluar, kurse për periudhën e njëjtë për këtë vit janë shpenzuar 625 €, kjo vlerë është trefishuar, mandej tek kodi 14310, shpenzimet për drekat zyrtare vitin e kaluar kanë qenë 7000 €, kurse për këtë vit kemi rreth 14.000 € e që i bie se kemi dyfishim të kësaj shume financiare. Për këto pyeti kryetarin e komunës se përse janë bërë këto shpenzime a mos për faktin se këtë vit ka qenë vit zgjedhor dhe është dashur të bëhen telefonata nga telefonat e komunës apo se reklamat janë bërë me mjete financiare të komunës a ndoshta edhe drekat janë shtruar me para të taksapaguesve tanë.

**Abit Abiti ZKF** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se si kryetar i komunës në vazhdimësi e ka përcjellë rrjedhën e planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetanake, për faktin se është normale që nuk mund të bëhet realizimi i investimeve kapitale nëse nuk kemi realizim të të hyrave në mënyrë të planifikuar. Në këtë kontekst njoftoi se vitin e kaluar Ministria e Financave ka bërë rritje të të hyrave vetanake në vlerën prej 36%, dhe kjo nuk dihet se në çfarë formule është bërë. Këtë vit nuk ka vazhduar kjo rritje, por të hyrat janë zvogëluar në një shifër simbolike, e që realisht kjo prapë do të shkaktojë vështirësi në realizimin e planit për inkasimin e të hyrave vetanake. Në këtë relacion pritjet janë të bazuara për realizimin e të hyrave në këtë vit, duke marrë për bazë borxhet që subjektet tjera i kanë komunës sidomos ato nga

shpronësimet në vlerën rreth 400.000 €, por pritjet janë edhe nga hyrja në fuqi e Ligjit për legalizimet. Lidhur me shpenzimet komunale ai vlerësoi se vazhdimisht ka tentuar që ato t'i kontrollojë dhe ceku se nëse punohet me dinamikë, atëherë normal se do të rriten shpenzimet.

#### 6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2016/2017

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit** - tha se e përgëzon drejtorinë përkatëse për punën që ka bërë qoftë në ngritjen e infrastrukturës shkollore, apo në realizimin e trajnimeve për mësimeve, si dhe në realizimin e garave dhe punë të tjera. Pastaj sa i përket testit të maturës vlerësoi se kemi ngritje veçanërisht tek shkolla e mesme teknike "Lutfi Musiqi". Kur bëhet fjalë për testin e arritshmërisë është brengosës fakti se kemi rënie dhe për këtë është mirë që drejtoria në fjalë të bëjë një hulumtim se përse ka ndodhur kjo. Mandej propozoi që në informatë të futen edhe sfidat me të cilat është përballur drejtoria siç ishte p.sh shkolla e muzikës e cila ka punuar në kushte të vështira. Pastaj shkolla profesionale e cila ka punuar me orar të shkurtuar për shkak të renovimit, kurse shkolla teknike e cila ka nevojë të rinovohet. Në fund tha se në informatë duhet të cekën edhe arsyet e braktisjes së shkollës nga nxënësit, por të vlerësohen edhe raportet mes Drejtorisë së Arsimit dhe Komitetit Konsultativ për Arsim.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – fillimisht paraqiti vërejtje për siç tha materiali për këtë pikë të rendit të ditës ka ardhur i pakompletuar dhe të dhënave të paraqitura në këtë informatë iu mungojnë përqindjet. Pastaj shtoi se në informatë gjithashtu nuk janë dhënë krahasime me vitin paraprak sa i përket kalueshmërisë dhe suksesit të nxënësve. Duke iu referuar statistikave të vitit të kaluar vlerësoi se hiç më mirë nuk është gjendja as këtë vit, ku në vitin e kaluar nxënës me sukses të dobët në përqindje kemi pasur rreth 61%, në gjysmëvjetorin e parë, kurse në gjysmëvjetorin e dytë nxënës me sukses të dobët kanë qenë vetëm 6%, e që nënkuptohet se kemi vlerësim jo real, apo rritje të suksesit në mënyrë joobjektive. Është mirë që të kemi rritje të përqindjes të suksesit në testin e maturës, por kjo nëse nuk korrespondon me ngritjen e suksesit në testin e kalueshmërisë, atëherë krijohen dyshime se testi i maturës ka mundur të jetë i kamufluar.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – tha se kjo informatë është mjaft e kompletuar, dhe kërkoi që herëve të ardhshme pjesa e fundit e kësaj informate që ka të bëjë me ndryshimet në listën e pagave për mësimeve të mos futet fare në informatë pasi kjo çështje i takon Drejtorisë së Arsimit. Pastaj kërkoi që në shkollat që kanë një hapësirë më të madhe të kemi mësim përparshkollorët. Duke iu referuar testit të arritshmërisë, ceku se vetëm në dy shkolla është arritur 50 % i kalueshmërisë, kurse shkollat tjera janë nën këtë përqindje e që kjo na bënë me dije se akoma jemi larg arritjes së cilësisë në shkollat tona. Në fund duke iu referuar shifrave të kalueshmërisë së nxënësve nëpër vite, ceku se në vitin 2017 kemi rënie të kësaj përqindjeje e kjo tregon se kemi regres në këtë drejtim.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga Drejtoria e Arsimit që forma e raportimit të jetë ashtu siç ishte më herët në tabela duke u dhënë statistika për secilën shkollë dhe për secilin nivel të klasave. Tutje shtoi se rezultatet në testin e maturës janë derivat i ndryshimeve që janë bërë në Ligjin për testin e maturës, në ç'rast të gjithë nxënësit e shkollave të mesme që e përfundojnë këtë shkollë marrin diplomë pa hy fare në provimin e maturës, kurse ata nxënës që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në universitet, duhet t'i nënshtrohen testit të maturës, andaj nxënësit që nuk kanë mundur të japin këtë provim i janë nënshtruar disa herë këtij provimi dhe rezultati është ky çfarë është prezantuar. Tutje vlerësoi se duhet të kemi angazhim të përgjithshëm e sidomos të krijohen kushte konkretizuese për punë praktike me qëllim që të ngritët cilësia në fushën e arsimit.

**Agim Miftari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke dhënë përgjigje në pyetjet e bëra nga anëtarët e kuvendit.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – vlerësoi se niveli i arsimit determinon të gjitha fushat e zhvillimit të një shoqërie dhe shteti. Në vazhdim ceku se deri më tani është punuar me zell në

kompletimin e infrastrukturës shkollore, në hapësirë dhe laboratorë për punë praktike e që këto janë premisa themelore për zhvillimin e arsimit. Tutje bëri me dije se nuk është i kënaqur me cilësinë, por apeloj për angazhim të përgjithshëm për ngritjen e kapaciteteve për rritjen e cilësisë në arsim. Në fushën e implementimit të përvojave, vlerësoi se duhet të kemi ndërlidhje të teorisë me praktikën, dhe kjo do të mund të bëhej përmes realizimit të praktikës për nxënësit e shkollës profesionale dhe teknike në bizneset tona.

7. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2017

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit** - tha se kur bëhet fjalë për planet operative të policisë, prioritet duhet t'u jepet parandalimit të ndezjes së zjarreve e sidomos për ndezjen e mbeturinave, si dhe keqpërdorimin e ujit të pijes. Tutje shtoi se policia duhet të ndër marrë masa sa i përket dukurisë së lëmshës në qytet, qoftë nga fëmijët apo nënat e tyre, dukuri kjo që ka marrë një hov të madh në qytetin tonë.

**Shaban Salihu, zëvendëskomandant i Stacionit Policor në Vushtrri** - paraqiti sqarime lidhur me informatën për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar - qershor 2017, si dhe dha përgjigje për temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Pastaj ai para anëtarëve të kuvendit paraqiti të dhëna lidhur me shkallën e kriminalitetit (statistika lidhur me veprat penale), në Komunën e Vushtrrisë.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – lidhur me thyerjen e zyrave të Lëvizjes Vetëvendosje, në ç'rast ka pasur vjedhje të kompjuterëve dhe të dokumenteve të ndryshëm, pyeti se deri ku kanë shkuar hetimet dhe a ka diçka konkrete në arrestimin e kryerësve të kësaj vepre penale.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – kërkoi nga organet policore që të shtohet numri i patrullimeve, në rrugët "Gj. K. Skënderbeu" dhe "Ismajl Qemajli", për shkak se ngasësit e automjeteve vozisin me shpejtësi jashtë rregullave të komunikacionit dhe parkimi i automjeteve bëhet në vendet joadekuate.

**Shaban Salihu, zëvendëskomandant i Stacionit Policor në Vushtrri** - u përgjigj në pyetje e anëtarëve të kuvendit.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – pasi e falënderoi zëvendëskomandantin e policisë, për bashkëpunimin që kanë pasur gjatë këtyre viteve, vlerësoi dhe apeloj tek organet policore që të ketë një angazhim më të madh sidomos në komunikacion me anë të patrullave policore, në sezonin kur kemi fluks të bashkatdhetarëve tanë që vinjë nga bota e jashtme, ashtu që të kemi preventiv në shkaktimin e aksidenteve të komunikacionit dhe në përgjithësi në ruajtjen e jetës së qytetarëve tanë.

8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore në Komunën e Vushtrrisë

9. Shqyrtimi i njoftimit për Raportin e auditimit për raportimin financiar vjetor të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2016

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – pyeti se a është hartuar plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm. Tutje shtoi se në rastin e dorëzimit të këtij raporti dhe të deklaratës së menaxhmentit, nuk kemi pasur saktësi të saj në kuadër të shumës financiare prej 204,000.00 € dhe kjo është bërë për shkak të regjistrimeve të gabuara në vlerën e cekur më lartë. Pastaj cekur se rekomandimet e auditorit të përgjithshëm prej 17 sa kanë qenë vitin e kaluar vetëm 6 janë zbatuar, kurse të tjerat kanë mbetur të pazbatuara, dhe këtu ka vend dhe kërkohet një mobilizim i përgjithshëm i akterëve komunal. Andaj lidhur me këtë duhet theksuar se çështja e pasqyrave financiare, e llogarive të arkëtueshme dhe ajo e pasurisë së komunës mbeten detyrë e vazhdueshme e autoriteteve komunale që të përmirësohen. Nga raporti shihet se për vitin raportues të hyrat janë realizuar në vlerën prej 84 %, kurse nga

21,417.00 prona të evidentuara për t'u tatimuar me tatimin në pronë, vetëm 1193 prona janë kontrolluar apo verifikuar nga ana e drejtorisë gjegjëse, e që ligjërisht 1/3 e këtyre pronave duhet të evidentohet për çdo vit, gjë kjo që nuk po bëhet dhe se kjo dukuri po përsëritet për çdo vit. Një tjetër dukuri e vërejtur në raport është pagesa në kategorinë joadekuante dhe kjo ka qenë vërejtje e veçantë e auditorit. Mandej tek menaxhimi i kontratave, kemi rreth tetë (8) raste ku auditori ka vërejtur se nuk janë mbajtur librat e ndërtimit, e që kjo lë hapësirë të madhe për manipulim dhe keqpërdorim. Në fund tha se duke i marrë për bazë të gjitha këto, apeloj që të kemi mobilizim të qeverisë komunale në hartimin e një plani të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm dhe për përmirësimin e gabimeve që auditori i ka konstatuar në këtë raport.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se edhe përkundër vërejtjeve që ka mundur t'i bëjë auditori, e rëndësishme është se auditori i përgjithshëm e ka vlerësuar pozitivisht komunën tonë, dhe se opinioni i auditorit është “i pamodifikuar me theksim të çështjes”, dhe kjo tregon që pasqyrat vjetore financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Megjithëkëtë auditori është logjike se gjithherë gjen vend për të bërë vërejtje dhe për të paraqitur rekomandime. Pastaj njoftoi se plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është hartuar dhe ai pritët të jetësohet në afatet optimale ligjore.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime profesionale, lidhur me raportin e auditorit të përgjithshëm duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – pasi e përgëzoi drejtorin për atë siç tha përgjigjet që i ka dhënë auditorit. Pastaj shtoi se roli i auditorit është që të ndikojë përmes auditimit në përmirësimin e qeverisjes. Në vazhdim ajo pyeti se përse edhe përkundër udhëzimit dhe kërkesës së bërë nga ana e Departamentit të Thesarit, që vlera financiare prej 270,000€ e cila ishte paguar në llogarinë e agjencisë impementuese të projektit Lux-Dev dhe e njëjta ishte regjistruar si shpenzim edhe pse nga thesari ishte kërkuar që kjo shumë të regjistrohej si avans, dhe të ngarkohet llogaria e investimit në vijim deri në përfundimin e projektit, mirëpo kështu nuk ishte vepruar nga ana e komunës. Pastaj shtoi se nga 17 rekomandime sa i kishte dhënë auditori, vetë, 6 prej tyre ishin zbatuar plotësisht. Në fund ajo kërkoi nga kryetari i komunës shpjegime, se a ka kërkuar nga drejtoritë komunale zbatimin e rekomandimeve të auditorit të jashtëm dhe sa nga ato rekomandime janë zbatuar.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – duke iu referuar parafolësës, sqaroi se rekomandimet e auditorit i adresohen kryetarit të komunës e jo drejtorive, sepse kryetari e udhëheq qeverinë komunale, kurse lidhur me zbatimin e rekomandimeve ceku se disa janë zbatuar plotësisht ndërsa të tjerat janë në proces. Lidhur me projektin e Lux-Dev-it, kjo kompani nga Luksemburgu, ka bashkëfinancuar projektin për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit projekt ky në vlerë prej 700,000€, por i gjithë defekti dhe vërejtja e auditorit ishte si rezultat se ligjet e republikës tonë nuk përkojnë me ligjet e Luksemburgut në disa raste, sepse në bazë të ligjeve tona mjetet financiare alokohen vetëm pasi të përfundojë projekti, kurse sipas ligjeve të Luksemburgut nuk mund të fillojë një projekt pa u alokuar mjetet dhe këtë problematikë e kanë pasur edhe komunat tjera të Kosovës. Në fund tha se në koordinim edhe me bashkëfinancuesin dhe me auditorin kjo problematikë do të tejkalohet dhe ky rekomandim do të zbatohet në plotni.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** –paraqiti sqarime shtesë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – në replikën e saj ceku se edhe përkundër kërkesës së thesarit dhe të auditorit, çështja e pagesës në llogarinë e Lux-Dev-it, nuk është përmirësuar ku ajo është evidentuar si kategori e shpenzimit e në fakt ajo është dashur të evidentohet si avans.

10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shndërrimin e projektit njëvjeçar në projekt dyvjeçar për hartimin e hartës zonale në Komunën e Vushtrrisë

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - paraqiti sqarime para anëtarëve të kuvendit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – tha se parimisht e përkrah këtë propozim për zgjatjen e afatit të këtij projekti nga njëvjeçar në projekt dyvjeçar, dhe kërkoi që ky projekt të realizohet sa më parë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet ndryshimi i afatit të projektit nga njëvjeçar në projekt dyvjeçar, lidhur me hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë, e cila përfshin më hollësishtë llojin e destinimit dhe shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Prokurimit dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

3.Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmer masat e nevojshme për implementimin e këtij vendimi në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi, të cilat e rregullojnë këtë çështje.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për destinimin e “shtëpisë së Mahmut agë Gjinolli” në muze historik-etnografik

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se e mbështetin këtë propozim-vendim dhe shtoi se investimi i mëhershëm që është bërë në shtëpinë e Mahmut agë Gjinolli”, ka qenë i dështuar dhe për këtë dikush duhet të japë përgjegjësi. Çështja tjetër të cilën ai e ngriti është shkolla e muzikës, e cila do të vendoset në këtë objekt, e që kjo shkollë sipas tij nuk e ka vendin në të njëjtin objekt me muzeun, për faktin se në muze duhet të mbretërojë qetësia dhe jo të dëgjohen tinguj muzikor. Andaj lidhur me këtë çështje ai kërkoi nga përgjegjësit që të gjendet ndonjë zgjidhje tjetër qoftë edhe ndërtimin e një objekti të ri për shkollën e muzikës, por jo në këtë formë të tentohet sepse kështu vetëm sa do të shkaktoheshin probleme më të mëdha.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – njoftoi se komuna jonë nuk ka shkollë të muzikës, porse ajo vetë është një paralele e ndarë e Shkollës së Muzikës të Mitrovicës. Tutje shtoi se në të ardhmen është menduar ndërtimi i një shkolle të muzikës, dhe për këtë ka interesim edhe nga donatorët, andej kuvendi duhet të angazhohet për gjetjen e një lokacioni për ndërtimin e kësaj shkolle. Në fund tha se ideja për destinimin e “shtëpisë së Mahmut agë Gjinolli” në muze historik-etnografik, është shumë e qëlluar në të gjitha aspektet.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – në përgjigjen e tij ndaj anëtarit të kuvendit z.Selaci njoftoi se investimi i parë në këtë objekt ka qenë nga Posta e Kosovës. Tutje shtoi se në atë kohë restaurimi i tij nuk është bërë në tërësi dhe për këtë ka mbetur pa u funksionalizuar si muze, andaj i njëjti kishte mbetur në mëshirën e kohës dhe kishte filluar të shkatërrohej në mënyrë graduale. Pastaj theksoi se për këtë mund të formohet ndonjë komision profesional i cili do ta vlerësonte këtë investim se a është i dështuar apo jo. Ndërsa sa i përket shkollës muzikës ajo është menduar që përkohësisht të vendoset në këtë objekt deri në gjetjen e një zgjidhjeje tjetër më të përshtatshme.

**Agim Miftari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.



**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** – tha se në këtë pikë të rendit të ditës është çështja e muzeut e jo ajo e shkollës së muzikës. Tutje shtoi se në ndonjë shkollë të qytetit do mund të bëhej një zgjidhje që të vendosen nxënësit e shkollës së muzikës pasi që ata janë në një numër simbolik dhe kjo do bëhej deri në gjetjen e një zgjidhjeje tjetër të përshtatshme.

**Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se kjo pikë duhet të aprovohet ashtu siç është ofruar nga qeveria komunale, kurse në mbledhjen e radhës mund të votohet propozimi i veçantë për destinimin e një pjese të shtëpisë së Mahmut agë Gjinollit” në shkollë të muzikës.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** – tha se ky propozim-vendim mund të aprovohet ashtu siç është, kurse ai për shkollën e muzikës do mund të aprovohej në mbledhjen e radhës.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim bëhet shndërrimi i shtëpisë së Mahmut agë Gjinollit (ish-ambulanca e vjetër) në Muze Historik-Etnografik.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

12.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin e vlerës financiare për ndërtimin e objektit shkollor në fshatin Dumnicë e Llugës

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 4 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim zgjatet afati kohor i ndërtimit, si dhe ndryshohet shuma e vlerës së përcaktuar me planifikim buxhetor për vitin 2017, për ndërtimin e shkollës së re SHFMU „Bajram Curri” në fshatin Dumnicë e Llugës.

2.Afati kohor për ndërtimin e shkollës në fjalë i planifikuar për dy (2) vite, zgjatet edhe për një (1) vit kalendarik, pra gjithsej tri (3) vite.

3.Vlera e shumës së paraparë me planifikim buxhetor për ndërtimin e shkollës në fjalë, nga 200,000.00 € ndryshohet në shumën prej 435,311.48 €, pra shumës prej 200,000.00 euro t’i shtohet shuma prej 235,311.48 euro.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Arsimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtoria e Prokurimit.

13. Shqyrtimi i Draft-planit për përmirësim të shërbimit – Mobiliteti në trafik 2017-2019 (shqyrtimi i dytë)

**Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke arsyetuar nevojën dhe rëndësinë e aprovimit të këtij plani, si bazë e mirë për joshjen e investimeve dhe donacioneve të ndryshme në fushën e rregullimit dhe mobilitetit të trafikut në komunën tonë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet Plani i Mobilitetit në Trafik 2017-2019 i Komunës së Vushtrrisë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Drejtoria e Inspektimeve.

3.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin <Plani i Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit - Mobilitetit në Trafik 2017-2019>.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

14.Shqyrtimi i Draft-planit Zhvillimor Komunale të Arsimit 2017-2019 (shqyrtimi i dytë)

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – kërkoi që në këtë plan të inkorporohen, si dhe të planifikohen mjete financiare për hapjen e klasave për parashkollorë në të gjitha shkollat e komunës sonë. Tutje propozoi që në plan të parashihet pranimi i psikologëve nëpër shkolla, për faktin se që nga paslufta ndjehet nevoja për këtë kuadër nëpër shkollat tona. Në lidhje me ekskursionet që po bëhen në Republikën e Shqipërisë, ai propozoi që këto ekskursione të hiqen dhe kjo të inkorporohet në këtë plan zhvillimor të arsimit.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** – tha se ky plan i plotëson kriteret që dalin nga udhëzimi i ri administrativ i nxjerr nga MASHT-ti. Pastaj lidhur me lekturimin e këtij dokumenti vlerësoi se në gjuhën shqipe ekzistojnë disa fjalë të përbëra, të cilat në kompjuter nuk dalin drejt dhe për këtë kërkoi që të bëhet përmirësimi i këtyre fjalëve. Mandej ceku se është mirë që të korrespondojë deklarata e vizionit me atë të misionit gjë që në këtë plan kjo ekziston. Pastaj në faqen 14 të këtij dokumenti ku flitet për trajnimin e mësimeve ceku se është kundër një deklarate të dhënë nga ministri i arsimit që shpenzimet për trajnimin e mësimeve t’i mbulojnë vetë ata. Lidhur me cilësinë pyeti se nëse një mësues nuk është në nivel të detyrës sipas koordinatorit të cilësisë, a do të mund Drejtoria e Arsimit të ndërmarrë masa ndaj tij dhe në të kundërtën nëse një mësues është në cilësi të lartë mbi pritjet e këtij plani, i njëjti a do të mund të shpërblehet. Në kontekst të zgjerimit në ofrimin e shërbimeve për parashkollorët ceku se prioritet duhet t’u jepet shkollave nëpër fshatra dhe kjo duhet të parashihet në këtë plan. Sa i përket renovimeve të shkollave ceku se duhet të bëhet rregullimi i shkollës fillore “Lumni Surdulli” në fshatin Smadrexhë. Në faqen 18 kërkoi që të bëhet një përmirësim teknik, ndërkaq në kuadër të rritjes së cilësisë në menaxhim, në fushën e arsimit vlerësoi se kishte me qenë mirë që të kemi një asociacion të drejtorëve të arsimit ku do të diskutoheshin çështje me rëndësi të arsimit. Në fund tha se ky plan është një bazë shumë e mirë në ngritjen e menaxhimit arsimor të Drejtorisë së Arsimit në veçanti dhe ngritjes së cilësisë së arsimit në përgjithësi, në shkollat e komunës tonë.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se miratimi i këtij plani del si obligim i një udhëzimi administrativ të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, dhe ceku se është mirë që ky plan po bëhet me kohë nga drejtoria kompetente. Tutje shtoi se kur bëhet fjalë për ekskursionet, duhet për të theksuar se është mirë që të shikohet kuadri ligjor që këto ekskursione të hiqen në tërësi. Ai këtë e arsyetoi me faktin se me këto organizime bëhet shumë shpenzime dhe gjithashtu ka mjaft telashe në përzgjedhjen e operatorit ekonomik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve për këto

vizita. Në kontest të Planit zhvillimor komunal të arsimit, ceku se duhet të inkorporohet arsimiti parafillor si i detyrueshëm në të gjitha shkollat.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – tha se kur jemi tek Plani zhvillimor i arsimit, materiali të cilin e kemi përpara është krejt ndryshe me atë i cili është dorëzuar para se të shkojë në diskutim publik. Bazuar në informatat që ka për këtë Plan zhvillimor për arsim e kanë përgatit duke u bazuar në raportet e drejtorëve të shkollave, të cilët kanë qenë të angazhuar ta përgatisin nga një raport gjithsecili, çka dua të them është se as ky raport dhe as ai tjetri nuk na garanton një cilësi në arsim në Komunën e Vushtrrisë. Po pavarësisht kësaj kam disa propozime, pyetje dhe këshilla lidhur me këtë PZHKA. Kur jemi tek siguria dhe zhvillimi i cilësisë në arsim është mirë të krijojmë një grup ekspertësh të jashtëm (jashtë DKA), të pranuar me konkurs vlerash, pa ndikim nga pushteti i cili do të vlerësonte në mënyrë të pavarur dhe reale gjendjen në terren dhe do ta hartonte një raport komunal si rekomandim për DKA-në, që të veprojë në shkollat apo proceset ku ka nevojë. Zhvillimi profesional i mësimdhënies, ndërtimi i mekanizmave për zhvillimin profesional duhet të hartohet, koordinohet, vlerësohet nga grupi i ekspertëve të pavarur politikisht, të cilët do të zbatonin raportet e MASH-it për këtë fushë. Përzgjedhja e mësimdhënësve të bëhet mbi bazën e rezultateve paraprake, nevojat e shkollës së caktuar, dhe efektin e zbatimit praktik të trajnimeve. Mbi bazën e kësaj, grupi i ekspertëve të pavarur politikisht do të hartonte raportet e vlerësimit profesional për këta mësimdhënës, ku do të merrej në konsideratë edhe stimulimi (një rroge apo bursë, avancim në vendin e punës etj.) Prioriteti i tretë, faqe 15 pika, 3.1 sigurimi i transportit zakonisht kemi probleme edhe vonesa në këtë pikë për nxënësit e rregullt edhe atëherë kur bëhet zgjedhja e transportit përfituesit janë militantë të partive, të cilët me herët apo në zgjedhje kanë bartur votues të një partie dhe që fatkeqësisht nuk i plotësojnë as kriteret teknike për një problem të tillë (vetura apo kombibusë teknikisht jo në rregull.). Kur jemi tek praktikantët që dërgohen nga shkolla profesionale tek bizneset, zakonisht përfitues janë bizneset partiake, të cilat shfrytëzojnë këtë mundësi për përfitimet të tyre, sidomos kur vjen në shprehje kryerja e obligimeve shtetërore. Pastaj keqpërdoren nxënësit të cilët detyrohen të punojnë me orar të tejzgjatur për nevoja të bizneseve dhe pa ndonjë stimulim shtesë. Rezultati nr. 1 Infrastruktura kemi probleme të mëdha, sepse kemi ndotje enorme në shkolla sidomos nëpër fshatra. Nuk ka një kalendar vjetor për dezinfektimin dhe deratizimin e shkollave, si pasojë e insekteve dhe minjtë si bartës të sëmundjeve janë pjesë e ambienteve shkollore. Pyetjet për Drejtorinë e Arsimit janë: çfarë plani është hartuar nga ju për depolitizimin e përzgjedhjes së drejtorëve dhe profesorëve në shkolla; mbi bazën e cilave kriteret përzgjidhen të njëjtit në detyrë; a keni hartuar deri më sot një listë me kriteret për përzgjedhjen përveç kriterit politik. - Deri në sa herë keni të drejtë që një ushtruesi detyrë të drejtorit t'ia vazhdoni mandatin pa hapur konkurs për drejtor. 4. A jeni në dijeni që deri më sot drejtorët që i keni emëruar të tillë nuk dinë punën me kompjuter si kusht themelor. 5. Mbi 80% të shkollave sot nuk i kemi as kushtet themelore për realizimin e pjesës praktike në shkencat ekzakte (fizikë, kimi dhe biologji). Në fund tha se ky plan komunal duke pa dinamikën e punës së DKA-së do të mbetet në letër dhe i pazbatueshëm për shkak të kapaciteteve jocilësore që keni si drejtori në përgjithësi. Gjithashtu propozoi ndërtimin e një shkolle në qytet, më konkretisht në regjionin e lagjes “Vneshta” e cila do të shkarkonte nga ngarkesa shkollën aktuale “Anton Zako Çajupi”, pra kjo të vijë si nevojë imediate për planin zhvillimor të arsimit në komunën tonë. Pasi siç shihet nga raporti i paraqitur më herët është intervenuar kryesisht në shkollat ku drejtorët janë nga pjesa e subjektit politik në pushtet dhe sigurisht që nuk kanë pas ndonjë strategji të caktuar.

**Agim Miftari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – pyeti se për sa mund të vazhdohet mandati ushtruesit të detyrës së drejtorëve nëpër shkolla dhe a do të ketë kalendar kohor për dezinfektimin e shkollave të komunës.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se bazuar në ligjet e Kosovës që janë në fuqi, një drejtor shkolle nëse ka sukses në punë mund të jetë në këtë pozitë deri në pension. Gjithashtu ai tha se asnjëherë si kryetar i komunës nuk ka bërë emërim të drejtorëve sipas përkatësisë partiake. Lidhur me ekskursionet vlerësoi se ato e kanë rëndësinë e tyre dhe shtoi se do të ishte vendim i gabuar nëse ato hiqen për faktin se janë të rregulluara me normativin arsimor dhe me udhëzime administrative.

**Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit** – pyeti se ushtruesi i detyrës në pozitën e drejtorit të shkollës a ka mandat të kufizuar apo ajo korrespondon me qëndrimin në pushtet të një partie politike. Pastaj shtoi se përzgjedhja e drejtorëve nëpër shkolla nuk është bërë sipas kriterit të performancës, por sipas militantizmit partiak. Në fund tha se nga radhët e LDK-së është vetëm një drejtor shkolle që tregon se partia në pushtet ka vendosur militantë politik në pozitat e drejtorëve të shkollave. Kurse nëse drejtori i shkollës që zgjidhet me konkurs, atëherë ai nuk ka të drejtë të jetë edhe anëtar i kuvendit pasi që kjo është në konflikt me ligjin.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se duke u bazuar në ligjin e arsimit, pozitën e drejtorit mund ta ushtrojë një ushtruese detyre deri në zgjedhjen e drejtorit. Gjithashtu ai konfirmoi se asnjë drejtor shkolle nuk është ndërruar apo emëruar sipas përkatësisë politike.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** – tha se nga praktika del në sipërfaqe fakti se të gjitha partitë politike me të ardhur në pushtet i kanë vendosur në pozita menaxhuese njerëzit e tyre mbi baza partiake dhe kjo ka ndodhur edhe nëpër shkolla. Tutje shtoi se në këtë plan a është paraparë ngritja e kapaciteteve nëpër shkollat profesionale me qëllim që të kemi njerëz për të përgatitur për tregun e punës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se fatmirësisht për dhjetë vitet e udhëheqjes së PDK-së, nuk është larguar nga puna asnjë punëtor për ngjyrimet politike, por kjo nuk do të thotë që subjektet tjera politike kanë vepruar kështu sepse në praktikë kemi largim enorm të punëtorëve nga partitë tjera politike, për shkak të përkatësisë partiake.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 6 votë “kundër” vendosi me sa vijon:

- 1.Me këtë vendim aprovohet Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit për periudhën 2017-2019.
- 2.Qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi, është miratimi i Planit zhvillimor komunal të arsimit.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorja e Arsimit.
- 4.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin <Plani Zhvillimor Komunal i Arsimit 2017-2019>.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
- 15.Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Pestovë

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se në kohën kur janë ndërtuar këto shtëpi, kontratat këtyre familjeve iu ishin dhënë për një vit, dhe tani këto kontrata kanë skaduar dhe këto familje nuk e kanë të rregulluar këtë çështje në kuptimin juridik. Duke e parë legjislacionin në fuqi aktualisht dhënia në shfrytëzim e këtyre banesave nuk mund të bëhet pa

konkurs publik. Andaj në këtë rast i rekomandoi Drejtorisë së Shëndetësisë që t'i vazhdojë ato kontrata që palët i posedojnë aktualisht.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" vendosi me sa vijon:

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale që banorëve të këtyre banesave t'iu vazhdohet kontrata e shfrytëzimit edhe për një (1) vit, sipas ligjit që ishte në fuqi në kohën e dhënies në shfrytëzim të këtyre banesave, pasi që edhe kontratat që i kanë këta banorë japin mundësinë e vazhdimit të drejtës së shfrytëzimit të këtyre banesave.

#### Sqarim:

Legjislacionin në fuqi (Ligji për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme, neni 6.2) parasheh: Dhënia e pronës së paluajtshme e komunës në shfrytëzim afatgjatë, bëhet përmes konkursit të hapur publik me kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Andaj në referim të dispozitave të këtij ligji vazhdimi i të drejtës së shfrytëzimit do të mund të bëhej vetëm përmes institucionit të konkursit.

*Gjithashtu Kuvendi kërkon nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale që banorët e këtij fshati parashtrues të peticionit, të njoftohen me shkrim për shqyrtimin e peticionit nga ana e Kuvendit të komunës, si dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e drejtorisë lidhur me çështjen në fjalë.*

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për krijim të marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe partneritetit në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Norwalk të IOWA-s (SHBA);

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se nga bashkëpunimi që ka pasur FSK-ja, komuna dhe KFOR-i, ka dalë propozimi për lidhjen e marrëdhënieve mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës Norwalk të IOWA-s (SHBA). Ideja e krejt kësaj ka qenë që të gjendet një komunë e një shteti që e ka të zhvilluar bujqësinë dhe konsulli i shtetit të IOWA-s, ka vlerësuar që komuna që do binjakëzohet me Komunën e Vushtrrisë është Komuna Norwalk. Për themelimin e bashkëpunimit nevojitet vendimi i kuvendit që të konkretizohet bashkëpunimi mes dy komunave tona.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** – tha se e përkrah këtë propozim-vendim, dhe njoftoi se një delegacion i FSK-së është duke qëndruar në shtetin e IOWA-së, dhe atje janë shpalosur projektet, të cilat ata janë të gatshëm t'i realizojnë në komunën tonë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Komuna e Vushtrrisë vendos marrëdhënie të bashkëpunimit dhe partneritetit me Komunën Norwalk të Iowa-s, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Autorizohet Kryetari i Komunës që të fillojë procedurat e konsultimeve dhe koordinimit të përbashkët me përfaqësues të komunës nga pika paraprake e këtij vendimi, për hartim të draft-marrëveshjes të bashkëpunimit në fushat me interes të ndërsjellë që do të përcaktohen në marrëveshje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

17. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozimit për heqjen e taksës për mbeturinat, si kusht për ofrimin e shërbimeve komunale

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se kushtëzimi për ofrimin e shërbimeve komunale me pagesën e taksës për mbeturina, është paraparë me Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave dhe me Planin për menaxhimin e mbeturinave, andaj heqja e kësaj takse do të mund të bëhej vetëm me ndryshimin e këtyre dokumenteve, por jo me vendim të kuvendit, pasi këto dokumente për t'u ndryshuar duhet të shkojnë në diskutim publik.

**Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke cekur bazën ligjore për një kushtëzim të tillë. Në vazhdim ai paraqiti të dhëna shtesë lidhur me procesin e menaxhimit të mbeturinave.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se gjatë udhëheqjes së tij gjithëherë është munduar që të respektojë ligjet, dhe në rastin konkret ka bindje se është në pajtueshmëri me ligjin. Tutje shtoi se taksa për menaxhimin e mbeturinave nuk është e lartë dhe se kushtëzimi për ofrimin e shërbimeve tjera me pagesën e kësaj takse nuk është në kundërshtim me ligjin.

**Albanez Tahiraj, zyrtar i lartë ligjor** - paraqiti sqarime profesionale lidhur me çështjen e kushtëzimit të pagesës së kësaj takse me ofrimin e shërbimeve tjera komunale dhe gjithashtu lexoi para anëtarëve të kuvendit dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – tha se aplikimi i këtij kushtëzimi në pagesën e taksës për mbeturina, për ofrimin e shërbimeve komunale, është shkelje e të drejtave të qytetarëve, dhe në të njëjtën kohë është kundërligjore, në ç'rast konstatoi se asnjë komunë tjetër përpos Komunës së Vushtrrisë nuk e ka aplikuar një rregull të tillë.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – tha se obligimet nga ana e qytetarëve duhet të kryhen, dhe shtoi se është e padrejtë dhe kundërligjore rregulli që të kushtëzohen qytetarët në këtë formë. Pastaj ajo njoftoi se dy komuna tjera ajo e Klinës dhe Istogut e kanë aplikuar rregullin e kushtëzimit, dhe për këtë MAPL kishte dhënë vlerësim negativ. Në fund ajo vlerësoi se ky kushtëzim duhet të hiqet duke u ndryshuar rregullorja dhe plani përmes procedurave formale të parapara me ligj, duke i dërguar në diskutim publik dhe pastaj kuvendi do t'i bënte ndryshimet e kërkuara.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se është evident fakti se menaxhimi i mbeturinave nuk është duke u bërë ashtu siç duhet, andaj për këtë kemi qenë të detyruar që t'i aplikojmë këtë kushtëzim në të kundërtën nuk kishte pasur nevojë që të aplikojmë kushtëzimin e pagesës së kësaj takse. Pastaj ai vlerësoi se nëse aplikohet ky instrument i kushtëzimit, nuk është se “dënohet” qytetari, porse kjo bëhet që të lehtësohet procesi i inkasimit të të hyrave për kompaninë dhe kështu ngritët cilësia e shërbimit në menaxhimin e mbeturinave. Në të kundërtën e kësaj ndaj qytetarit do të aplikoheshin gjopa për mospagesë të obligimeve dhe kështu vetëm sa do të rëndohej situata e qytetarëve tanë.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** – tha se kur bëhet fjalë për menaxhimin e mbeturinave duhet thënë se kompania për menaxhimin e mbeturinave ka probleme të brendshme për shkak të borxheve. Tutje shtoi se është që ky kushtëzim të hiqet fare për faktin se ka shumë qytetarë të cilëve nuk u janë marrë mbeturinat dhe ai është futur në listën e obligimeve dhe është kushtëzuar dhe kjo nuk është e drejtë. Në fund tha se pajtohet që nga ky vit të aplikohet rregulli i kushtëzimit, por jo edhe për borxhet të cilat janë grumbulluar më herët, sepse me këto borxhe duhet të merret kompania duke i ekzekutuar përmes përmbaruesit privat.

**Islam Latifi, zyrar i DSHP-së** - paraqiti sqarime lidhur me temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se edhe përkundër përpjekjeve të shumta gjendja me menaxhimin e mbeturinave nuk është e mirë, dhe këtu apostrofoi fshatin Pestovë. Tutje ceku se rekomandimi i kuvendit për DSHP-në është që nga data 1 janar 2018 të zbatohet rregulli i kushtëzimit, kurse për borxhet e vjetra kompania të merret vet me këtë çështje.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 27 korrik 2017, pas shqyrtimit të kërkesës së anëtarit të kuvendit Rrahim Ajeti, për heqjen e kushtëzimit për ofrimin e shërbimeve komunale me pagesën e taksës për mbeturinat nga ana e qytetarëve dhe në këtë rast parashtron këtë:

### REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrisë i rekomandon Drejtorisë së Shërbimeve Publike, që të fillojë t'i zbatojë dispozitat e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, lidhur me kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve komunale me pagesën e taksës për mbeturina nga data 01.01.2018, duke u bazuar në faktin se nga kjo datë do të ketë kontraktim të ri të këtyre shërbimeve.

*Gjithashtu Kuvendi kërkon nga Drejtoria në fjalë që deri në datën e lartcekur të mos ketë kushtëzim të qytetarëve me pagesën e kësaj takse si kundërvlerë e ofrimit të shërbimeve të ndryshme komunale, pasi që aktualisht komuna nuk merret me inkasimin e taksës për mbeturina.*

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit të UÇK- së

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – njoftoi se më datë 20 korrik është mbajtur një diskutim publik, me përfaqësuesit e fshatrave që gravitoheshin nga Batalioni i I-rë i Brigadës 142 të UÇK-së. Në këtë takim përpos përfaqësuesve të fshatit Zhilivodë, të tjerët në mënyrë unanime ishin pajtuar që ky lokacion të jetë në fshatin Gllavatit.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – gjithashtu theksoi se përpos përfaqësuesve të fshatit Zhilivodë, të cilët e kishin lëshuar takimin, përfaqësuesit tjerë ishin pajtuar që ky lokacion të jetë tek vendi i quajtur “Ura e Gllavatinit” në fshatin Gllavatit.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – tha se për diskutimin publik i cili është mbajtur më datë 20 korrik, kanë qenë të ftuar ish-komandanti i ZOSH, i cili nuk ka mundur të marrë pjesë pasi që ishte jashtë vendit, gjithashtu i ftuar ka qenë ish-komandanti i Brigadës 142 Enver Oruqi, i cili nuk ka shprehur vullnet të marrë pjesë dhe të merret me këtë problem. Në takim ka marrë pjesë ish-komandanti i Batalionit Aziz Bici dhe zëvendësi i tij, ku pas shumë diskutimesh përfaqësuesit e fshatit Zhilivodë e kanë lëshuar takimin në shenjë mospajtimi. Në këtë relacion ai propozoi që në shenjë kompromisi të ndërtohet një pllakë në fshatin Zhilivodë, ku do të cekej se shtabi i parë i UÇK-së, në nënzonën e Çiçavicës ka qenë në fshatin Zhilivodë. Në fund tha se lokacioni më ideal për ndërtimin e këtij lapidari është fshati Gllavatit.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – tha se është kundër që ky monument të ndërtohet qoftë në fshatin Stroc apo Zhilivodë, për faktin se në një të ardhme jo të largët parashihet që këto fshatra të shpronësohen nga termo-centrali “Kosova e Re”.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – propozoi që të dy propozimet për lokacion të dalin në votim dhe cila i merr votat le të aprovohet.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se për ndërtimin e pllakës nuk është problem, pasi që komuna ka një kontratë me një kompani për ndërtimin e pllakave dhe kjo do të bëhej shumë shpejt.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – shprehu shqetësimin e tij lidhur me mospajtimet e shprehura nga përfaqësuesit e fshatit Zhilivodë dhe shtoi se pasi që nuk ka konsensus, atëherë ai si anëtar i kuvendit do të abstenojë.

**Nezir Klinaku, drejtor i DMSH-së** - tha se kishte me qenë mirë që edhe njëherë të tentohet të gjendet një marrëveshje me përfaqësuesit e fshatit Zhilivodë, dhe në të kundërtën nëse këta të fundit nuk pajtohen atëherë mos të ndërtohet fare ky lapidar.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se nuk kishte dëshiruar që si rezultat i këtij vendimi të lindin mosmarrëveshje mes veteranëve të UÇK-së, dhe shtoi se në një takim që kishte pasur me Gjeneral Ramën, i kishte thënë atij që nëse gjenerali do të jepte një propozim përfaqësuesit e Zhilivodës do ta pranonin sepse këtë e kishte dëgjuar nga vetë përfaqësuesit e fshatit Zhilivodë. Andaj si përfundim ai sugjeroi që ky vendim të shtyhet për ca kohë se mos po gjendet një zgjidhje e pranueshme nga të gjithë.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – tha se pajtohet me propozimin e kryetarit të komunës, që të gjendet një marrëveshje e pranueshme nga të gjitha palët.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se e mbështet propozimin që të gjendet një marrëveshje e pranueshme nga të gjitha palët dhe që ky monument të jetë pikë që i bashkon të gjithë e jo që të shkaktojë përçarje.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – tha se ndoshta është keqkuptuar, por qëllimi i tij ishte që të arrihet një konsensus mes të gjitha palëve dhe që ky projekt të ndërtohet sa më parë.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – tha se duhet të kemi kujdes që mos të lëshohemi në fyerje personale, dhe ceku se pajtohet me propozimin që të autorizohet kryetari i komunës që pasi të gjendet një marrëveshje, të caktojë lokacion për ndërtimin e këtij lapidari.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

- 1.Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës që të përcaktojë lokacionin për ndërtimin e lapidarit për Batalionin e I-rë të Brigadës 142, të Zonës Operative të Shalës, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
  2. Përcaktimi i lokacionit për ndërtimin e lapidarit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të bëhet pas arritjes së marrëveshjes me përfaqësuesit e fshatit Zhilivodë.
  - 3.Autorizohet Kryetari i Komunës që të zhvillojë konsulta me përfaqësuesit e fshatit Zhilivodë, për arritjen e një marrëveshjeje për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit të lartcekur.
  - 4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës, si dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
  5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.
- c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve buxhetore të lira të komunës

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:



1.Me këtë vendim lejohet ridestnimi i mjeteve të lira buxhetore brenda kategorisë së kapitaleve në kuadër të programit të njëjtë nga një projekt në projektin tjetër.

2.Mjetet buxhetore, të cilat ridestinohen nga projektet kapitale janë në kuadër të programit planifikimi urban dhe inspektimet (66425), kodi funksional 0620 nga projektet si në vijim:

2.1 Asfaltimi i rrugës “Musa Surdulli” në Samadrexhë, mjetet e lira në shumën prej 3,474.75€;

2.2 Asfaltimi i rrugës “Veli Osmani” në Dalak, mjetet e lira në shumën prej 2,627.85€;

2.3 Asfaltimi i rrugës “Ahmet Ademi”, mjetet e lira në shumën prej 3,658.20€;

2.4 Asfaltimi i rrugës “Çlirimi” në Mihaliq, mjetet e lira në shumën prej 1,740.45€;

2.5 Asfaltimi i rrugës “Shefqet Isa” në Dumnicë, mjetet e lira në shumën prej 2,095.62€;

2.6 Asfaltimi i rrugës “Rexhep Rrzhana” në Sfaraçak, mjetet e lira në shumën prej 2,389.37€;

2.7 Asfaltimi i rrugës “Selman Maloku” në Samadrexhë, mjetet e lira në shumën prej 1,843.83€;

2.8 Asfaltimi i rrugës “Abedin Maxhuni” në Maxhunaj, mjetet e lira në shumën prej 3,655.20€;

2.9 Asfaltimi i rrugës “Qemajl Jashari” në Ashlan, mjetet e lira në shumën prej 1,195.65€;

2.10 Asfaltimi i rrugës “Mulliri i Shpëtimit” në Ashlan, mjetet e lira në shumën prej 552.20€.

3.Shuma e mjeteve të lira buxhetore të cekura në pikën 2 të këtij vendimi, në vlerë prej 23,233.12€, ridestinohen në projektin- asfaltimi i rrugës “Zylfije Krasniqi”.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5.Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin e mjeteve financiare të komunës

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim rialokohen mjetet brenda kategorisë së mallrave dhe shërbimeve në kuadër të programit të njëjtë, kategorisë së njëjtë nga një nënkategori në tjetrën nënkategori të shpenzimeve në shumën prej 1,000.00€

2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij vendimi rialokohen nga blloku kodues 10/644/18184/13505/00000/0451 shuma prej 1,000.00€ të destinuar për blerjen e makinës fotokopjuese, rialokohen në bllokun kodues 10/644/18184/13509/00000/0451 në shumë të njëjtë (1000.00€) me përshkrimin “pajisje tjera” (me qëllim të blerjes së dy makinave kositëse).

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

d). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Hasime Ahmetin.

dh). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Fahrije Gërgurin.

e). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Naser Hysenin.

Lidhur me këto tri pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i Komunës - Fondi për bashkëfinancim me donatorë për Hasime Ahmetin me banim në Vushtrri, në shumën prej 1000 € (një mijë euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të meremetimit të shtëpisë së Hasime Ahmetit.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i Komunës - Fondi për bashkëfinancim me donatorë për Mexhit Merovcin, i cili është duke ia ndërtuar shtëpinë Fahrije Gërgurit me banim në Vushtrri, në shumën prej 1500 € (një mijë e pesëqind euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të ndërtimit të shtëpisë së Fahrije Gërgurit.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i Komunës - Fondi për bashkëfinancim i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për Mexhit Merovcin, i cili është duke ia ndërtuar shtëpinë Naser Hysenit me banim në Gojbulë- Vushtrri, në shumën prej 2500 € (dy mijë e pesëqind euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të ndërtimit të shtëpisë së Naser Hysenit.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

ë). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim Komuna e Vushtrrisë bën këmbimin e pronës së paluajtshme, parcela kadastrale P-70202040-00976-0, në sipërfaqe prej 6850m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Dumnicë e Llugës, pronë e Rrahman Rustollit nga Dumnicë e Llugës; parcela kadastrale P-70202040-00975-0 në sipërfaqe prej 1125m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Dumnicë e Llugës, pronë e Avdullah Rustollit nga Dumnicë e Llugës; parcela P-70202040-00974-0 me sipërfaqe prej 1045m<sup>2</sup>, pronë e Adem Rustollit nga Dumnicë e Llugës dhe parcela P-70202040-00973-0 me sipërfaqe prej 1045m<sup>2</sup>, ZK Dumnicë e Llugës pronë e Sabit Rustollit nga Dumnicë e Llugës, me pjesën e parcelës kadastrale P-70202040-01248-0, në sipërfaqe prej 23015m<sup>2</sup>, pjesë e parcelës P-70202040-00564-0 me sipërfaqe prej 17877m<sup>2</sup>, pjesë nga parcela kadastrale P-70202040-00563-0 me sipërfaqe prej 26130m<sup>2</sup> Zona Kadastrale Dumnicë e Llugës, në sipërfaqe që do të caktohet pas vlerësimit nga organi kompetent, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2.Këmbimi i pronave, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të sigurimit të hapësirës së nevojshme për shkollën e fshatit Dumnicë e Llugës.

3.Obligohet kryetari i komunës që në afat prej pesë (5) ditësh, pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës të bëjë kërkesë në Ministrinë e Financave-ZVPP-së për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të cilat janë objekt i këmbimit, si dhe të lidhë kontratë për këmbimin e pronave me pronarin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë parcializimin e ngastrave kadastrale në sipërfaqen e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

f). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:


**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** – pyeti kryetarin e komunës, se a ka mundësi që të ndërtohet një pllakë me mbishkrimin si post-blok i kontrollit të Zonës Operative të Shalës, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e cila do duhej të ndërtohet në fshatin Pasomë.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – ngriti shqetësimin e saj, që në fshatin Gumnishtë ka filluar shfrytëzimi i zallit, ku janë hapur vrima të thella në ç'rast kur fillojnë reshjet atmosferike ato gropa do të mbushen me ujë dhe kështu do të shkaktohej rrezik për banorët e atij fshati. Andaj kërkoi që organet kompetente të dalin në vendin e ngjarjes dhe t'i ndërmarrin masat adekuate.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** – tha se është i njoftuar me shqetësimin të cilin e ngriti anëtarja e kuvendit znj. Ismajli, dhe bëri të ditur se ai ka marrë obligim që në fshatin Gumnishtë t'i dërgojë inspektorët komunal për ta shikuar vendin e ngjarjes dhe për t'i ndërmarrë masat e duhura.

Mbledhja përfundoi në orën 16:00.


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit